

Rregullore shtëpiake

Për qendrat e strehimit për refugjatë-, parashtres kërkesh azili- dhe të personave pa strehim në komunën e Odenthal-it

Parathënia

Për të arritur dhe strehuar të shpërngulurit, parashtresit e kërkeshave për azil, refugjatët dhe personat tjerë të pastrehë, komuna e vendit Odenthal i vë në dispozicion qendrat e strehimit, të cilat ju shërbejnë një strehimi të përkoshëm të grupeve të personave të përshkruar më lartë. Prandaj në bazë të kësaj nuk rezultojnë të drejta ligjore dhe obligime detyruese në mes të banoreve dhe banorëve në njërin anë dhe të qendrës administruese në anën tjetër bazuari në parimet ligjore private të një kontrate të rregullt qiraje.

Për përdorimin e qendrave të strehimit të cilat administrohen nga ana e komunës së Odenthal-it për vendosjen nën strehim të parashtresve të kërkeshave të azilit, të të shpërngulurve, refugjatëve dhe të personave të pa strehë, lëshohet kjo rregullore shtëpiake- dhe përdorimi me vlefshmërinë e sajë ligjore bazuari në parimet e § 2 të Rregullores ligjore për ndërtimin dhe administrimin e shtëpive për strehim të përkohshëm në komunën e Odenthal-it të së dates 16.07.1991 dhe atë me sa edhe vijon më tutje:

§ 1

Obligimet e përgjithshme

Bashkëjetesa në shtëpitë e përbashkëta të strehimit kërkon patjetër të ekzistojë një konsideratë e ndërsjellë në mes të banorëve. Secila banorë/ secili banor është i obliguar për tu adaptuar në bashkësinë e banimit dhe të sillet në atë mënyrë, që personat e tjerë mos të dëmtohen, të rrezikohen ose të jenë të ngacmuar si dhe të mos vjen deri tek dëmtimi apo rrezikimi i gjësendeve të cilat qëndrojnë në pronësi të një personi tjetër. Komuna e Odenthal-it me anë të kësaj dëshiron veçanërisht të arrijë të krijojë një mundësi bashkëjetese paqësore dhe të qetë pa marrur parasysh nacionaliteti, religjioni dhe gjinia që kanë.

§ 2

Pranimi në qendër

1. Reparti i organit për shërbime civile rregullon dhe përcakton ndarjen e dhomave përgjatë pranimi në qendër për strehim bazuari në vendimin për vendosjen e tyre. Shkëmbimi dhe ndërrimi i dhomave të përcaktuara më parë nga qendra për strehim nuk është e lejueshme të bëhet nga vetë ana e banorëve në mënyrë të paautorizuar më parë.
2. Me sa edhe është e nevojshme për përmbushjen e detyrave, është e mundshme të vijë deri tek një rivendosje nga vetë ana e qendrës strehuese.

§ 3

Përdorimi i dhomave dhe i pajisjeve të përbashkëta

1. Dhomat e përcaktuara është e lejueshme të banohen vetëm nga ana e atyre personave, të cilëve edhe ju janë ndarë ato dhoma për banim. Përsonat të cilët nuk janë përcaktuar për banim atje nuk është e lejueshme të pranohen në ato dhoma.
2. Banoret dhe banorët janë të obliguar të trajtojnë dhomat e vendosjes për banim si dhe të gjitha pajisjet e amvisërisë, mobilet, si dhe të gjitha apartet tjera të vëna në dispozicion nga ana e komunës të ruajnë ato mirë dhe të trajtojnë të njëjtat në mënyrë të kujdesëshme.

Një e tillë vëln gjithashtu edhe për të gjitha stabilimentet e përbashkëta, siq janë kuzhinat, dhomat për larjen e rrobave dhe dhomat sanitare si dhe njëherit edhe zona e jashtme e banimit.

Dhomat e banimit dhe ato të përbashkëta duhet të ajrosen në mënyrë të mjaftueshme. Në rast të pengesave apo të dëmtimeve tek stabilimentet elektrike të vëna në dispozicion është për tu ndërprerë menjëher përdorimi i tyre dhe njëherit të bëhet menjëher informimi i përkujdesuesit (punëtorit/punëtorës për çështje sociale, kujdestari shtëpiak ose përpunuesit/përpunueses të lëndës së shërbimeve) ose i përfaqësuesit të tyre.

Tepihat, tabllot për shkundjen e këpucave, tepihat e koridoreve, rrobat dhe gjërat tjera të ngjajshme është e lejueshme të shkunden dhe të pastrohen vetëm në hapsirat e jashtme të oborrit.

Për të pastruar rrobat janë për tu përdorur vetëm dhomat e larjes së rrobave të cilat janë vënë në dispozicion. Në qoftë se banoret/banorët nuk janë në gjendje të dakordohen me njëri tjetrin në lidhje me përodrimin e të njejtave, atëher personi përkujdesës i qendrës së strehimit do të përpiloj një planë përdorimi të përbashkët. Rrobat janë për tu tharë vetëm në hapsirat të cilat janë përcaktuar për një të tillë. Varrja dhe nxjerrja e rrobave në dritare dhe vendosja e stabilimenteve elektrike të tharjes pranë dritareve nuk është e lejueshme. Gjithashtu nuk është e lejueshme që ditëve të Diela dhe përgjat ditëve festash të përgjithshme të behet varrja apo shtrirja e rrobave të lara në hapsiren e jashtme.

Mbajtja e çfardolloy kafshësh në dhomat e banimit si dhe në të gjithë terenin e shtëpive të strehimit është parimisht e ndaluar. Leje të veçanta janë të mundshme vetëm në raste tejet të veçanta të lejuara me atë rast nga ana e repartit të organit për shërbime civile.

Nuk është e lejueshme të bëhet përdorimi i dhomave të banimit dhe e stabilimenteve tjera të qendrave të banimit për qëllime komerciale apo të ju lejohet personave tjerë të tretë shfrytëzimi i përbashkët i qendrave të banimit me kryerje apo pa kryerje pagese. Buajtjet e personave tjerë të tretë, të cilat tejkalojnë një periudhë kohore prej më shumë se tri ditë, janë të lejueshme vetëm me anë të një miratimi të mëparshëm nga ana e repartit të organit për shërbime civile.

Dëmet apo defektet në qendren e strehimit, në pajisjet apo në objektet e qendres së strehimit janë për të ju lajmruar menjëher përkujdesësit të qendres së strehimit apo përfaqësuesve të tijë.

Të gjitha pajisjet dhe mobilet të cilat janë vënë në dispozicion nga ana e komunë së Odenthal-it nuk është e lejueshme të largohen në mënyrë të paautorizuar nga qendra e strehimit. Rregulloret individuale janë patjetër për tu aranzhuar më parë me përkujdesësin e qendrës së strehimit apo me përfaqësuesit e tijë.

Hyrja në sipërfaqen e oborrit të qendres së strehimit me anë të automjeteve, motoçikleteave dhe me anë të mjeteve tjera vozitëse të ngjajshme nuk është e lejueshme. Reparti i organit për shërbime civile mund të lejojë në raste të veçanta një përjashtim rregulli.

Automjetet e personave është e lejueshme të parkohen në terenin e qendres së strehimit vetëm në sipërfaqet e parkimit të përshkruara për parkim. Riparimi i automjeteve ose i motoçikletave është parimisht i ndalueshëm.

Në qoftë se një banore/ një banor vë në përdorim aparate të radiovalëve- ose të televizionit, atëher ajo/ apo ai sipas nevojë duhet bëjë lajmrin dhe regjistrimin e të njejtave me vetëshpenzime tek qendra për pagesën e shërbimeve të tilla.

Në qoftë se një banore ose një banor pas përfundimit të marrëdhënies së përdorimit të qendrës për strehim lenë gjësende prapa në qendrën e strehimit, në ato raste të tillat do të mbahen në ruajtje maksimalisht 1 javë. Pas skadimit të këtij afati ato gjësende do të asgjësohen kur kemi të bëjmë me një mosvlerë të dukshme; ndërsa në raste të tjera sipas mundësie bazuari në rregulloret e parimeve ligjore §§ 983, 979 e në vazhdim e sipër të BGB-së (Kodi civil) të njejtat do të nxirren në ankand. Përfitimet me atë rast do të mbahen në ruajtje për një periudhë kohore prej gjashtë muajsh. Ai përfitimi më pastaj do të shfrytëzohet për mirëmbajtjen e ndërtesave të qendres së strehimit për refugjatë, parashtrues kërkesash azili dhe për persona të pastrehë.

Secila banore / secili banor repektivisht secila amvisëri do të pranojë përgjat hyerjes së tyre në qendrën e strehimit një çelës banese, i cili çeleës në vazhdim e sipër mbetet edhe më tutje pronë e komunës dhe për atë arsye është për tu kthyer prapë me rastin e largimit definitiv nga qendra e strehimit.

Në lidhje me secilen qendër strehimi është e mundshme të përcaktohen nga ana e kryetarit të komunës rregullore plotësuese përdorimi- dhe sjelljeje, të cilat më pastaj do të publikohen në secilen prej qendrave të strehimit në një vend qendror.

Banorët janë të obliguar të përmbushin obligimet e tyre të përkujdesit ndaj fëmijëve të tyre që kanë.

3. Të gjitha stabilimentet shkollorë- dhe sportive të cilat gjinden të lokalizuara në afërsi të një qendre strehimi mund të përdoren vetëm pas një leje të marrur me parë nga ana e përkujdesësit të qendres

së strehimit. Përdoruesit e autorizuar të këtyre stabilimenteve (shkollat, shoqatat, grupet përdoruese të

autorizuara) kanë gjithnjë përparësi përdorimi dhe nuk duhet të pengohen.

Përdorimi i "Dhünntalstadion"-it

Ditëve të javës

Prej orës 07:00 deri në ora 17:30

Përdorimi nga ana e shkolles

Ditëve të javës

Prej orës 17:30 deri maksimalisht në ora 22:00 Përdorim nga shoqata

Jashta këtyre orarëve të kohës vlenë në mënyrë paraprake një përdorim i veçantë i sipërfaqeve sportive i miratuar nga ana e komunës më parë.

Përdorimi i oborrove shkollore dhe stabilimenteve sportive të shkollave

Ditëve të javës

Prej orës 07:00 deri në ora 17:30

Përdorim nga ana e

shkolles- dhe OGS-se (shkollave publike gjithëditore)

Jashta këtyre orarëve të kohës vlenë në mënyrë paraprake një përdorim i veçantë i sipërfaqeve sportive i miratuar nga ana e komunës më parë.

§ 4

Mirëmbajtja e pastërtisë

1. Korridori, shkallët si dhe stabilimentet të cilat përdoren në mënyrë të përbashkët janë për tu pastruar nga vetë ana e banorëve me ndërrime javore. Në qoftë se banoret/banorët nuk janë në gjendje të dakordohen me njëri tjetrin në lidhje me rrjedhimin javor, atëher personi përkujdesës i qndres së strehimit do të përpiloj një planë pastrami të cilit duhet të ju përmbahen të gjithë.
2. Dhoma e larjes së rrobave, rubinetat e ujit, lavamanët, dhomat e dushit, vendi i tharjes së rrobave dhe të tjerat të ngjajshme, janë për tu pastruar nga secila banorë/secili banor pas secilit përdorim nga ana e tyre. Bllokimet në rrjedhim ujërash janë për tu menjanuar menjëher dhe – në qoftë se një e tillë nuk është e mundshme nga vetëndihma – një e tillë është për të ju lajmruar menjëher personit përkujdesës për qendrën e strehimit.
3. Banoret dhe banorët duhet të mirëmbajnë sipërfaqet e ambientit të jashtëm gjithnjë të pastërta. Ai i cili zhytë objektet e jashtme më shumë se që është e zakonshme, e ka për obligim që më pas të menjanoj atë zhytje menjëher.
4. Në qoftë se mund vërtetohet prezenca e kafshëve dëmtuese, atëher është menjëher për tu informuar reparti i organit për shërbime civile. Ai organ më pastaj do të kujdeset për një dezinfektim dhe dezinfestacion të menjëhershëm. Në qoftë se është e patjetërsueshme, një gjë e tillë edhe mund të realizohet në mozhprezencë dhe kundër vullnetit të banoreve/banorve.
5. Mbeturinat është e lejueshme të hudhen vetëm në kantat e bërlllogut të parapara për një menjanim të tillë **e jo** në toaleta, lavamane e në kanalizime të ujërave të zeza. Ambienti për rreth kantave të bërlllogut është për tu mirëmbajtur gjithnjë i pastërt.

Gjërat e rënda penguese nuk është e lejueshme të hudhen në kantat e bërlllogut. Ato janë për tu vendosur në rrugë një ditë para terminit të marrjes së tyre. Përgjat periudhës kohore të mbetur në mes të terminave të marrjes së tyre nuk është e lejueshme që materiali të vendoset në magacinim në terrenin e qendres së strehimit.

Gjithashtu edhe platformat e çative të shtëpive të strehimit nuk është e lejueshme të përdoren apo të hyhet në to si vende magacinimi.

Në lidhje me orarët e marrjes së mbeturinave biologjike, ricikluese, letrës dhe të bërlllogut të rëndë pengues, administrata e qendrës së strehimit do të informoj në mënyrë të veçantë nëpërmes varrjes së terminave në tabelë publikimi.

§ 5

Siguria e qarkullimit- dhe e zjarrit - und Feuersicherheit

1. Secila qendër e strehimit është e pajisur me një fikës zjarri. Fikësi i zjarrit është për të qëndruar gjithnjë në dispozicion për përdorim në zonën e hyerjes së ndërtesës.

Secili person i vendosur në strehim duhet të jetë në gjendje, që në rast të shpërthimit të një zjarri të bëjë përdorimin e rregullt të fikësit se zjarrit.

Për atë arsye realizohet për të gjithë banoret/banorët e qendres për strehim rregullisht (së paku 1x në vitë) një instruksion në lidhje me përdorimin e rregullt dhe funksionimin e fikësve të zjarrit. Në këtë aktivitet duhet që secila banore/secili banor të ketë marrur së paku një herë pjesë. Informimi në lidhje me aktivitetin e tillë do të bëhet nga ana e përkujdesuesit të qendrës për strehim ose përfaqesuesve të tijë ditën se kur organizohet ai instruksion përdorimi.

Vendosja apo magacinimi i gjësendeve – siq janë biçikletat, karrocet e fëmijëve, arkat, mobilet, ose gjërat e ngajshme – në korridoret dhe hyerjet e ndërtesës ose në terenin e qendrave të strehimit nuk është e lejueshme. Me sa një e tillë është patjetër e nevojshme reparti i organit për shërbime civile do të vë në dispozicion vende adekuate për vendosjen e gjësendeve të tilla.

Nuk është e lejueshme, të bëhet vendosja e motoçikletave dhe e biçikletave motorike në shkallët e shtëpisë, në korridore, hyerjet e podumeve dhe në dhomat e podrumit.

Banoret dhe banorët e kanë për detyrë që sipërfaqet e ambientit të jashtëm – me sa edhe dhomat e tyre të banimit mjaftojnë - ti mbajnë të lira nga reshjet e borës dhe akulli dhe njëherit të bëjnë edhe hudhje të lëndëve për shkrirjen e të tillës.

Dhomat e magacinimit të gjësendeve janë për tu zbratur në intervale të duhura kohore për arsye të sigurisë ndaj zjarrit dhe në bazë të kërkesës së bërë nga ana e përkujdesuesit të qendres për strehim. Magacinimi i gjësendeve të rrezikshme për zjarrë dhe flakë të hapur nuk janë të lejueshme. Për arsye të sigurisë se mbrojtjes ndaj zjarreve pajisjet elektrike janë për tu mbrojtur ndaj dëmtimeve të mundshme. Ndryshimet në to janë të lejueshme vetëm me një miratim nga ana e repartit të organit për shërbime civile dhe vetëm nën rrethanën, që punimet të kryhen me atë rast nga ana e një elkticisti të koncesionuar duke patur me atë rast patjetër parasysh rregulloret e VDE-së (Shoqata për elektroteknik, elektronik dhe teknik informative).

Në dhomat dhe në terenin e qendrave të strehimit është e lejueshme të bëhet përdorimi vetëm i pajisjeve elektrike të verifikuara sipas VDE-së (Shoqata për elektroteknik, elektronik dhe teknik informative).

2. Vendet e gatimit dhe të djegjes duhet patjetër ti përkasin rregulloreve ligjore dhe njëherit të garantojnë një siguri për mbrojtjeje të mjaftueshme ndaj zjarrit.

§ 6

Mirëmbajtja ndërtimore

1. Mirëmbajtja ndërtimore e qendrave të strehimit, të stabilimenteve të përbashkëta si dhe të stabilimenteve të jashtme janë detyrë e repartit udhëheqës ndërtimi & shërbimet teknike.
2. Riparimet e lehta brenda mureve të dhomave të banimit – siq janë vendosja e tapetave dhe ngjyrosja e mureve dhe platformave – do të realizohen – pas një dakordimi të mëparshëm me përkujdesuesin e qendres për strehim - nga vetë ana e banoreve dhe banorve.
3. Dëmet janë për tu ju lajmruar menjëher repartit të organit për shërbime civile. Secila banore/secili banor është i obliguar, që brenda mundësive të saja/të tijë të ndermarrin masa të përkoshme dhe të pajtëtsueshme sigurie, të cilat janë të përshtatshme të menjanojnë një dëmë respektivisht një zgjerim të atij dëmi.
4. Ndryshimet strukturore në ndërtim, ndryshimet në pajisjet e furnizimit ose vendosja e aparaturave tjera shtesë ose stabilimentesh nuk janë të lejueshme. Sa i përket montimit të antenave është patjetër e nevojshme të mirret më parë një leje e duhur nga komuna e Odenthal-it.

Të gjitha antenat dhe pjatat satelitore të cilat janë vendosur pa një leje të nevojshme do të largohen sërish nga ana e komunës së Odenthal-it duke i detyruar me atë rast pronarët e tyre për pagesën e shpenzimeve të largimit të tyre. Nuk është e lejueshme të ndërtohen arbore, shtëpiza, stalle ose stabilimente tjera ndërtimore në terenin e qendrave të strehimit.

§ 7

Pengesat përshkak zhurmës durch Lärm

1. Te gjitha banoret dhe të gjithë banorët janë të obliguar të marrin njëri tjetrin në konsideratë. Zhurma dhe zhurmat tjera penguese në dhomat e qendrës së strehimit dhe në vendet e oborrit të shtëpisë janë për tu shmangur; e veçanërisht janë për tu evituar patjetër pengesat e zhurmshme përgjat orarit të kohës prej orës 13.00 deri në ora 15.00 dhe prej orës 22.00 deri në ora 7.00.
2. Përgjat përdorimit të aprateve të radios dhe atyre televizive, gramafonëve, magnetofonëve, instrumenteve muzikore dhe atyre të ngjashme duhet të ju përmbaheni një zëri me lartësi dhome dhe që mos të vjen deri tek pengimi i personave të cilët nuk kanë të bëjnë me një të tillë.

§ 8

Përgjegjësia

1. Banoret dhe banorët mbajnë përgjegjësin për dëmet e kirjuara sipas rregulloreve ligjore të Kodit civil (BGB).
2. Për pronen private të dëmtuar apo të humbur komuna e Odenthal-it nuk mban përgjegjësin.
3. Për dëmet, të cilët i pësojnë banorët në qendrat e strehimit, komuna e Odenthal-it nuk merrë fare përgjegjësin e plotë- ose bashkëpërgjegjësin mbi vete, me përjashtim në rastet kur ato dëmtime janë krijuar me plotë qëllim ose përshkak të pakujdesisë së rëndë nga ana e një puntori zyrtar i komunës.

§ 9

Përfundimi i marrëdhënies së përdorimit

Përgjat një përfundimi të marrëdhënies së përdorimit banorja/ apo nbanori janë të obliguar të dorëzojnë repartit të organit për shërbime civile të pastruara dhomat e dhënura në dispozicion dhe të kthejnë të gjitha çelësat dhe inventarin e dorëzuar përgjat hyrjes së tyre.

§ 10

E drejta shtëpiake

1. E drejta shtëpiake ju nënshtrohet repartit të organit për shërbime civile. Udhëzimet e ushtruara nga ana e përkujdesuesve të qendrës / të porositurve në atë detyrë (shërbimi i sigurisë / bashkëpunonjësit administrativ / kujdestarve shtëpiak / punëtorve për çështje sociale) janë për tu përmbajtur.
2. Te porositurit në detyrë të repartit të organit për shërbime civile gëzojnë të drejtën ligjore, të hyjnë brenda dhomave të qendrës së strehimit dhe në dhomat tjera të jashtme dhe atë brenda orareve të zakonshme të kohës. Prandaj për këtë arsye nuk është e lejueshme të bëhet ndërrimi i cilindrave mbyllës të derëve në vetëiniciativ apo pa një autorizim të mëparshëm nga ana e repartit të organit për shërbime civile.

Ndërrimi i bravave mbyllëse në mënyrë të paautorizuar më parë nga qendra, do të ju vëhet në llogari atyre personave të cilëve ju janë përcaktuar dhomat për banim.

§ 11

Marrja në konsiderim

Rregullorja shtëpiake – dhe ajo e përdorimit është për tu marrur në secilen prej qendrave të strehimit në një vend qendror. Përveq kësaj në mënyrë shtesë secili/a banor/e do të pranojë të dorëzuar edhe nga një ekzemplar – sipas mundësie në gjuhën angleze, franceze

ose arabe – për të mund marrur të njëjten në konsideratë duke vërtetuar me nënshkrim dorzimin e të njëjtës.

§ 12 **Kundërvajtjet**

Kundërvajtjet ndaj kësa rregullore shtëpiake është e mundshme të saksionohen me anë të masave edukative përgjat pagesës së pagesave mirëmbajtëse ose nëpërmjet të një transferimi në qendra tjera të strehimit.

Në qoftë se kemi të bëjmë me një veprim penal (p.sh. vjedhje, tregti me substance narkotike, lëndime fizike, kundërshtime ndaj ligjit mbi armët), parimisht do të behet një kallzim penal dhe njëherit do të ju revokohet e drejta për banim në qendren e deritanishme të strehimit.

Odenthal, den 22. April 2016
Komuna Odenthal
Kryetari i komunës

Der Bürgermeister



Robert Lennerts